



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 07.03.2025
Numër Protokolli: 1502/2025

A.nr.166/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.166/2025, të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesi V.A, kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.166/2025, e datës 22.01.2025, e parashtruar nga ankuesi V.A.

II.Anulohet në tersi konkursi me Nr. Reference: RN00015138 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit i shpallur nga Inspektoratit i Punës.

III.Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranim të këtij vendim, të ndërmerr veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil V.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 22.01.2025 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00015138 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit i shpallur nga Inspektoratit i Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 31.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa ky i fundit më datë 05.02.2025 ka përcjellë fare përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorie administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 435/2025, të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Konkursin me Nr. Reference: RN00015138 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit i shpallur nga Inspektorati i Punës; Njoftimin e datës 28.10.2024; Njoftimin për mbajtjen e testit me shkrim datës 19.11.2024; Njoftimin për shpalljen e kandidatëve fitues i datës 24.12.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 05.02.2025; Vendimin me numër protokollit 2430 i datës 13.09.2024 për shpalljen e konkurseve për Inspektor të Punës; Listën e aplikantëve; Vendimin me numër protokollit 3049 të datës 18.11.2024 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Lista e rezultatit të testit me shkrim; Formularin e vlerësimit të esesë i datës 26.11.2024; Aplikacionin e ankuesi i datës 12.10.2024 me 3 faqe; Aplikacionin e kandidatës A D-B i datës 26.09.2024 me 1 faqe, Aplikacionin e kandidatit L.Z të datës 27.09.2024 me 2 faqe; Aplikacionin e kandidat B.M të datës 27.09.2024 me 3 faqe; Aplikacionin e kandidat Q.Sh të datës 28.09.2024 me 2 faqe.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 13.09.2024 ka shpallur konkursin me Nr. referencës RN00015138 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës numri i kërkuar gjashtë, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit i shpallur nga Inspektorati i Punës, me afat aplikimi nga data 14.09.2024 deri më datë 13.10.2024.

Tutje në këtë konkurs, kanë aplikuar 159 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesi, ndërsa pas përfundimit të procedurës sipas konkursit të cekur si më lartë, më datë 24.12.2024 është publikuar njoftimi me numër protokollit 3376 për kandidatin fitues me katër kandidatë A.D-B me 83.6 pikë, L.Z me 82.6 pikë, B.M me 82.4 pikë dhe Q.Sh me 77.4 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon në padrejtësi në testin me shkrim pasi i njëjti ka qenë i përpiluar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullores për Procedurat e Pranimit në Shërbimin Civil sepse nuk kanë qenë pyetje sipas njohurive të pozitës punuese; Vendimin për formimin e komisionit të pranimit është nxjerr nga personi jo kompetent. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet procedura e pranimit.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit më numër të referencës RN00015138, dhe si rrjedhojë e analizimit të provave materiale ka konstatuar së z. H.N në cilësinë e Kryeinspektorit të Punës, më Vendimin më numër protokollit 2430 të datës 13.09.2024, ka obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës, që të bëjë shpalljen dhe zhvillimin e

procedurave të rekrutimit për pozitat e lira, në Inspektoratin e Punës, dhe atë Zyra Rajonale në Prishtinë, më gjithsej 21 pozita, Zyra Rajonale e Mitrovicës 4 pozita, Zyra Rajonale e Pejës 7 pozita, Zyra Rajonale e Prizrenit 8 pozita, Zyra Rajonale e Ferizajt 7 pozita, Zyra Rajonale e Gjilanit 6 pozita dhe Zyra Rajonale e Gjakovës 7 pozita. Me tej, z. H.N po në cilësi të Kryeinspektorit të Punës me datë 18.11.2024 nxjerrë Vendimin me numër protokollit 3049, për themelimin e Komisionit të Pranimit për vlerësimin profesional të kandidateve për konkurset për Inspektorë të Punës përgjegjës për të gjitha zyrat rajonale dhe atë në përbërje: kryetar-A.Ç, zëvendëses-B.L, anëtar-P.V., zëvendës A.O, anëtare-Gj.Q., zëvendëse-S.H, anëtar-N.Sh, zëvendësues-K.S, anëtar-F.F-zëvendësues-N.K.

Në kuptim të kompetencës dhe autorizimit ligjor për veprim në këtë procedurë, të z. H.N, si Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës, Kolegji i Këshillit vlerëson së i njëjti nuk ka poseduar autorizim ligjor që të ndërmerr veprime në këtë procedurë të pranimit, për arsye së Këshilli emërimin e tij si Kryeinspektor të Punës sipas Vendimit Nr.01/79, të datës 25.02.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e ka shpallur të paligjshëm, rrjedhimisht, Këshilli përmes monitorimit të jashtëzakonshëm ka vlerësuar së procedura e emërimit të z. H.N, sipas Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022, ka qenë në kundërshtim të plotë më përcaktimet ligjore të nenit 40 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publikë, dhe ka shkel rëndë parimet e pranimit të zyrtarëve publikë, të përcaktuara me dispozita e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik i aplikueshëm në atë kohë, duke rekomanduar Kryeministrin e Republikës së Kosovës, që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për anulimin e Vendimit Nr.01/79 të datës 25.02.2024.

Rrjedhimisht, Vendimi i Këshillit lidhur me procedurën e emërimit të z. H.N, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës të Nr.50/2022 të datës 14.07.2022, është vërtetuar si vendim i ligjshëm në të gjitha instancat gjyqësore, ashtu që kundër Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 të Këshillit më të cilin është aprovuar Raporti i Këshillit Për Monitorimin e Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, kjo e fundit kishte iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kurse gjykata më Aktgjykimin A.nr.1892/2022 të datës 14.04.2023, ka refuzuar padinë e palës paditëse-Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve si të pabazuar, duke konstatuar si të drejtë Vendimin e Këshillit me numër A.nr.50/2022 të datës 14.07.2022. Rrjedhësh, vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbet në fuqi si vendim i ligjshëm edhe pas mjeteve të rregullta dhe jashtëzakonshme juridike të ndërmarrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Gjegjesisht, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër AA.nr.354/2023 të datës 08.07.2024, ka refuzuar ankesën e palës paditëse-Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve duke vërtetuar Aktgjykimin me numër A.nr.1892/2022 të datës 14.04.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kurse Gjykata Supreme e Kosovës më Aktvendimin ARJ.nr.134/2024 të datës 25.09.2024, ka hedhur kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të shkallë së dytë.

Mirëpo, pavarësisht vendimit të Këshillit dhe vendimeve gjyqësore të lart theksuara, z. H.N ka vazhduar të ushtrij detyrën e Kryeinspektorit të Punës, dhe rrjedhimisht Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor në anulimin e vendimit lidhur me emërimin e z. H.N sipas Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022. Andaj, nisur nga fakti i pa kontestueshëm se të gjitha instancat gjyqësore të Republikës së Kosovës, kanë vërtetuar Vendimin Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin akt është vërtetuar se emërimi i Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendrorë të Punës, përmes Vendimit Nr.01/79, të datës 25.02.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i kundërligjshëm, atëherë, mbi këto rrethana ligjore Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër protokollit 2430 i datës 13.09.2024 dhe Vendimi me numër protokollit 3049 i datës 18.11.2024, të nxjerra nga z. H.N konsiderohen vendime të marra nga personi që nuk posedon autorizim ligjore dhe si të tilla janë veprime të paligjshme-nule në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme i cili përcakton se: *1.Një akt administrativ është i paligjshëm*

nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;

Nisur nga fakti së Vendimi me numër protokollit 2430 i datës 13.09.2024 (aprovimi i shpalljes së konkursit) dhe Vendimi me numër protokollit 3049 i datës 18.11.2024 (themelimi i Komisionit të Pranimit) janë veprime të paligjshme mbi arsyet si më sipër, atëherë, çdo veprim tjetër pasues i ndërmarr në këtë procedurë të pranimit cilësohet si veprim i paligjshme dhe nuk prodhon pasoja juridike, kështu që, mbi gjendjen e këtyre fakteve dhe konstatimeve, rezulton së procedura e pranimit më numër të referencës RN00015138 konsiderohet e pavlefshme, andaj, Këshilli bazuar në autorizimeve ligjore sipas nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme dhe nenit 18 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës aprovoj ankesën si të bazuar, anuloi në tërësi procesin e kontestuar të rekrutimit dhe detyroj Njësinë e Personelit të Inspektoratit të Punës që të ndërmerr veprime për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.166/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit V.A;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së